

PROCESVERBAL

**nga seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 3.2.2026**

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Goran Radunović, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, hapi seancën e 2-të publike të Këshillit. Seanca filloi në ora 12:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Televizija Sonce ShPKNJ P Prilep, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes.
2. Të ndryshme.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se kjo seancë, në pajtim me ligjin, është destinuar për arsyetim nga ana e radiodifuzorit në lidhje me shkaqet që çuan deri në heqjen e lejes. Ai shtoi se në seancën e ardhshme, kur pikë e diskutimit do të jetë shqyrtimi i heqjes së lejes, do të jipet shpjegim konkret në lidhje me arsyet pse është inicuar procedurë dhe pse propozohet heqja e lejes. Nëse përfaqësuesi i radiodifuzorit nuk është i pranishëm, seanca mbyllet. Drejtori edhe një herë sqaroi se seancat publike janë të destinuara ekskluzivisht për pronarin ose menaxherin e medias, përkatësisht për përfaqësues të televizionit ose radios.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, informoi se shërbimi profesional e ka njoftuar përfaqësuesin e televizionit „Sonce“ nga Prilepi, por nuk iu përgjigj ftesës për të marrë pjesë në seancën publike për të dhënë arsyetimin e tij.

Pika 2

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën „Të ndryshme“.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Zëvendëse e kryetarit të Këshillit,
mr. Zirjeta Jajaga**

Përktheu: Antoneta Shabani